

Bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika d të ligjit “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësishë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës” (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numër 103/09) dhe nenit 61 paragrafi 2 të ligjit “Për administratën publike” (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës”, numër 32/02 dhe 102/09), Ministri i Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike nxjerr:

## **UDHËZIMIN**

### **PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E RREGULLIMIT TË IMPORTIT DHE EKSPORTIT TË PËRKOSSHËM DHE TRANSITIT TË ARMËVE DHE MUNICIONEVE SPORTIVE DHE TË GJUEISË.**

#### **Neni 1 (Objekti i Udhëzimit)**

Ky Udhëzim rregullon mënyrën dhe procedurën e eksportit dhe importit të përkohshëm dhe transitit të armëve dhe municioneve sportive dhe të gjuetisë (në vijim referuar si: eksporti, importi dhe transiti i përkohshëm) për qëllime të pjesëmarrjes në veprimtari të organizuara trajnimesh, garash dhe gjuetie.

#### **Neni 2. (Përkufizimet)**

- (1) Termat e përdorura në këtë Udhëzim kanë kuptimin e mëposhtëm:
- a) armë sportive janë armë zjarri me tytë të gjatë të lëmuar të kalibrit deri në 12 mm, me tytë me vjaska të kalibrit deri në 8,61 mm, përkatësisht 0,338 inç dhe armë me tytë të shkurtër të kalibrit deri në 11,43 mm, përkatësisht 0,45 inç;
  - b) armë gjuetie janë pushkë gjuetie të kalibrit 4-36 (me tytë të lëmuar) ose karabina gjuetie të kalibrit 6,5-8 mm (tytë me vjaska) të cilat përdoren për gjueti;
  - c) armët e kalibrit të vogël janë të gjitha llojet e pushkëve dhe të pistoletave të cilat përdorin municion të kalibrit 5,6 mm;
  - d) armët me ajër janë të gjitha llojet e pushkëve dhe të pistoletave të cilat nën trysinë e ajrit të ngjeshur ose të gazeve të tjera shkrepin nga tytat e tyre saçme (“diabolo”) të kalibrit 4,5 mm;
  - e) municioni qëllimi bazë i të cilit është përdorimi në armët sportive dhe të gjuetisë, përkatësisht kalibrat dhe llojet e municioneve të specifikuara në pikat a, b, c dhe d të këtij paragrafi;
  - f) stërviçjet e organizuara, garat dhe aktivitetet e gjuetisë janë aktivitete sportive dhe të tjera të cilat organizohen jashtë vendit dhe në Bosnjë-Hercegovinë ku organizatorët ftojnë anëtarë të shoqatave sportive profesionale vendase (qitje ose ski-biathlon) që janë edhe anëtarë të shoqatave të gjuetarëve.
- 2) Armët e përmendura në paragrafin 1, pikat a, b, c dhe d të këtij neni nuk mund të përdoren në mënyrë specifike për qëllime ushtarake, d.m.th. për përdorim nga policia, dhe as nuk mund të jenë të llojit tërësisht automatike.

#### **Neni 3. (Kërkesa për marrjen e lejes)**

(1) Leja për importin, eksportin e përkohshëm dhe transitin jepet nga oficeri i doganës me kërkesë të subjektit juridik apo personit fizik.

(2) Kërkesa në paragrafin 1 i këtij neni përfshin në veçanti:

a) emrin dhe mbiemrin e personit që do të përdorë armën;

b) adresën në të cilën dërgohen ose transportohen armët;

c) dokumentin e identifikimit të armëve sportive apo të gjuetisë si më poshtë:

1) për armët sportive - Listën e armëve, pajisjeve të armëve dhe municioneve të certifikuara nga shoqata profesionale vendase ose klubi i qitjes (numri i serisë së armës, prodhuesi, kalibri i municionit, pajisjet ndihmëse që shoqërojnë armën);

2) për armët e gjahut – lejen për mbajtjen e armës;

d) mjetet/mënyrën e transportit;

e) datën e nisjes dhe datën e parashikuar të kthimit;

f) ftesën e organizatorit drejtuar konkretisht subjektit juridik ose personit fizik;

g) pikën e kalimit kufitar në hyrje dhe në dalje.

Neni 4.  
(Dhënia e lejes)

Importi i përkohshëm, eksporti i përkohshëm dhe transiti mund të lejohen maksimumi për tre armë sportive ose armë gjahu për person së bashku me pajisjet ndihmëse për këto armë dhe një sasi të caktuar municioni për çdo armë në varësi të kalibrit të tyre si më poshtë:

a) për armët sportive:

1) plumba 12 mm deri në 500 copë;

2) fishekë për qitje 12 mm deri në 500 copë;

3) plumba 5,6 mm deri në 3000 copë;

4) saçme “diabolo” 4,5 mm deri në 5000 copë;

b) për armët e gjahut:

1) fishekë 4-36 deri në 100 copë;

2) plumba 6,5-8 mm deri në 20 copë.

Neni 5.  
(Dispozita shtesë)

(1) Armët dhe municionet sportive dhe të gjuetisë duhet të jenë në bagazhet personale të personit për të cilin është lëshuar leja për importin e përkohshëm, eksportin e përkohshëm dhe transitin.

(2) Autoriteti doganor është i detyruar të kontrollojë listën e plotë të armëve dhe municioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, si edhe të kryejë verifikimin e tyre.

(3) Organizatori i përmendur në nenin 3 paragrafi 2 pika f duhet të lëshojë certifikatën për numrin e plumbave të përdorur nga pjesëmarrësit në aktivitetin në të cilin janë ftuar.

Neni 6.  
(Shfuqizimi)

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi mbaron dhe vlefshmëria e Udhëzimit “Për mënyrën dhe procedurën e rregullimit të eksportit të përkohshëm, importit të përkohshëm dhe transitit të armëve dhe municioneve sportive dhe të gjahut” (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës”, numër 56/05).

Neni 7.  
(Hyrja në fuqi)

Ky Udhëzim hyn në fuqi tetë ditë pas publikimit të tij në “Fletoren Zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës”.

Numër: 07-1-02-803/10  
2.3.2010  
Sarajevë

**MINISTRI**  
**Mladen Zirojević**

Publikuar në “Fletoren Zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës”, numër 19/10 datë 15.3.2010